**PROCESVERBALI I MBLEDHJES DATE 25.11.2025**

Sot ne sallen e mbledhjeve te K. B. Devoll zhvillohet mbledhja e radhes sipas njoftimit te dates 21.11.2025. Te pranishem ne salle:

Alfredi Gjata ,Valbona Spaho,Imelda Cucka,Esmeralda Medolli,Kledi Cenkolli,Festim Kaso,Oliver Mulla
Trifon Meraku,Lindita Cokani,Vladimir Kello ,Genti Demcolli,Vladimir Gjyli

**Alfredi Gjata:** Vazhdojme me piken 1, miratimin e rendit te dites.

*Hapet votimi: 12 pro, 0 kunder, 0 abstenim*

**Alfredi Gjata:** Vazhdojme me piken 2 "Miratimi i procesverbalit te dates 28.10.2025".

*Hapet votimi: 12 pro, 0 kunder, 0 abstenim*

**Alfredi Gjata:** Vazhdojme me piken 3, Projekt-Vendim Nr.66 Datë 20.11.2025 "Për miratimin e ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar deri në 6% për blok-ndihmën ekonomike dhe fondet e buxhetit vendor për muajin Tetor 2025."

*Nuk ka diskutime.*

*Hapet votimi: 12 pro, 0 kunder, 0 abstenim*

**Alfredi Gjata:** Vazhdojme me piken 4, Projekt-Vendim Nr.67 Datë 20.11.2025 " Për miratimin e taksave dhe tarifave të Bashkisë Devoll për vitin 2026."

**Bledi Kanina:** Ne kemi bere konsultime publike ne te gjithe njesite administrative ne lidhje me taksat dhe tarifat e Bashkise Devoll. Kemi hartuar paketen fiskale dhe kemi paraqitur relacionin perkates. Taksat nuk kame ndonje ndryshim. Ndryshimi i vetem eshte qe kemi hequr tarifen per mirembajtjen e kanalizimeve te ujerave te zeza, kemi shtuar mirembajtjen e rugeve rurale.

*Ne salle vjen keshilltari Ilir Hoxha dhe Oljana Comka.*

*Hapet votimi: 14 pro, 0 kunder, 0 abstenim.*

**Alfredi Gjata:** Vazhdojme me piken 5, Projekt-Vendim Nr.68 Datë 20.11.2025 "Për miratimin e linjave për transportin e punonjesve arsimore që punojnë dhe të nxënesve që mësojne jashtë vendbanimit."

*Hapet votimi: 14 pro, 0 kunder, 0 abstenim.*

**Alfredi Gjata:** Vazhdojme me piken 6, Projekt-Vendim Nr.69 Datë 20.11.2025 "Për ndalimin e ushtrimit të aktivitetit blegtoral brenda zonave të banuara të Bashkisë Devoll."

**Eduard Duro:** Jane 2 projektvendime qe i iniciova mbledhjen e kaluar per heqjen e bagetive nga territori i qytetit te Bilishtit per ti dhene formen e qendrave te banuara. Kjo eshte per te gjithe bashkine e Devollit.

**Vladimir Kello:** Nese ka turp dhe krim jane bagetite qe rrine afer varrezave te qytetit Bilisht. Ne bashkebisedim me qytetaret dhe ketu gjithesecili percakton vije kufitare te qytetit, sepse behet

edhe arkitekt edhe urbanist ne ndertim. Gjithmone duhet pasur parasysh vijakufitare e qytetit. Si e gjykoni ju?

**Eduard Duro:** Ne varreza jane problem edhe qente dhe eshte duke u aplikuar nje projekt per mbledhjen e gjithe qeneve qe jane te braktisur.

**Alfredi Gjata:** Gjeja e pare duhet te vaksinohen, e dyta te sterilizohen dhe sipas parametrave europiane supozohet te adoptohen. Por kjo nuk ka funksionuar dhe nuk fuksionon ne vendin tone.

**Festim Kaso:** Ne mund te ndihmojme ne dhenie toke per ndertim te ketyre qendrave per kujdesin e tyre.

**Esmeralda Medolli:** Persa i perket ketij projetvendimi, mund te shtoj dicka? Une vij nga fshati, stallen e kam mbrapa shtepise, ky vendim eshte i vonuar. Ne keto momente une nuk mund ta zhvendos. E kam siguar zahirene e cdo gje tjeter. Nuk kam kohe qe ta zhvendos per nje muaj apo dy.

**Eduard Duro:** Jo, afati per ta zhvendosur eshte nje vit.

**Festim Kaso:** Nuk mund te barazojme fshatin me qytetin, ne fshat eshte shume e veshtire ta aplikosh kete.

**Maksi Hoxha (specialisti):** Problemi eshte qe ne qytet eshte e qarte kjo situate, 400m larg qytetit sepse kanje plan urbanistik dhe qyteti pritet te zgjerohet. Kurse fshati sa vjen dhe po tkurret. Problemi eshte qe kemi pasur raste kur nje familje ka stalle je kes te lagjes, ku mbajne 2-3 lope. E mira eshte te trajtohet rast pas rasti, sepse nuk mund ta zbatoe si ne fshat ashtu edhe ne qytet.

**Genti Demcolli:** jetojme ne nje zone rurale dhe perpara se te marrim vendime kaq drastike, nga ana tjeter jemi dhe konsumatore. Jemi vete qe themi shyqyr jemi ne kete zone per pjesen bio, cmimin. Qumeshtin e marrim qumesht, vezet po ashtu. Nga njera ane kerkojme qe te kemi keto nga ana tjeter duhet te kemi pak kriter. Sepse ketu lexon: Deri ne sekuestrim. Do kaloje neser nje zoteri me bageti, keni ndonje studim nga do kaloje?

**Eduard Duro:** Jo stalla duhet te ike nga qendra e fshatit. Ne qytet kam cdo dite ankesa, tani po me shtohen me shume ne fshat.

**Imelda Cucka:** Tani meqe po flasim per zogj qyteti zogj fshati, ska rendesi, te gjithe kemi komunitet dhe duam ambiente sa me te pastra. Aktivitet blegtorial, quhet edhe kur mban betem nje bageti?

**Maksi Hoxha:** Nje bageti e vetme eshte me keq sepse pret nje muaj per te hequr plehun sepse nuk i grumbullohet, kurse ai qe ka 10 e heq perdite. Prandaj e thashe qe duhet ta marrim rast pas rasti.

**Festim Kaso:** Kryeplaku duhet te merret me keto raste, duke i bere njerezit te sensibilizohen te pakten.

**Vladimir Kello:** Edhe Satrivac eshte i njejti problem me stallat e fshatit qe ndodhen atje.

**Oliver Mulla:** Eshte e vertete se atje vene 1 milion njerez ne Satrivac.

**Eduard Duro:** Duhen marre masa edhe aty sepse hyn nerruge kryesore te fshatit.

**Ilir Hoxha:** Ketu e 10 vjet keshtu ka per te qene, sepse po nuk iku brezi qe i mban bagetite ska per te pasur ndryshim.

**Eduard Duro:** Nuk eshte me ai densitet qe ka qene.

**Genti Demcolli**: Aksesi i ujit te pijshem, elektriciteti do te garantohet? Une jam dakord ne parim por jam mosbesues ne zbatim.

**Eduard Duro:** Per stallat e medha po.

*Hapet votimi: 13 pro, 1 kunder, 0 abstenim.*

**Alfredi Gjata:** Vazhdojme me piken 7

**Alfredi Gjata:** Vazhdojme me piken 7, Projekt-Vendim Nr.70 Datë 20.11.2025 "Për lejim të

shfrytëzimit te hapësirës publike me qellim biznesi bar-kafe/ fast food dhe restorant, përgjatë pedonales të aytetit të Bilishtit pa pedanë , vetëm vendosje të tendave pa mbështetëse dhe cadrave si dhe ndalimin e vendosjes të cadrave dhe tavolinave në trotuarin në krahun e djathtë që nga sheshi | qytetit deri në rreth-rrotullimin në rruga e Mirasit."

**Eduard Duro:** Ne pedonale do te lejohet shfrytezimi i saj me cadra dhe tavolina, por jo me pedana.

**Genti Demcolli:** Para nje viti ishit personalisht qe kerkuat, tekstualisht: Nuk dua ne pedonale te padisiplinuar pa pedane te mbyllur. Tani pse e ndryshuat?

**Eduard Duro:** Sepse eshte urdher i kryeministrit.

**Genti Demcolli:** Sepse kryeminstri vendis per ujesjellesin, sepse do kete, sepse neser do doje qe mos te jete Bashki Bilishti.

**Eduard Duro:** Un i kerkoj ndjese dhe subjekteve te cilet investuan ne krijimin e atyre pedaneve, ne do te gjejme mundesine ti lehtesojme ne taksat dhe tarifat e Bashkise, por jo te dalim kundra vendimeve te qeverise.

*Hapet votimi: 13 pro, 1 kunder, 0 abstenim*

**Alfredi Gjata:** Vazhdojme me piken 8, Projekt-Vendim Nr.71 Datë 20.11.2025 "Për një ndryshim nê pikën 3 te vendimit nr. 76 datë 28.10.2025 "Për miratimin e kerkeses se Bashkise Devoll se bashku me dokumentacionin tekniko-ligjor për akordimin e ndihmës financiare për familjen e Z.Gëzim Bono , banues në fshatin Pilur, Njësia administrative Progës, banesa e të cilit është djegur plotësisht si rezultat I një shkëndije elektrike në banesën e tij."

*Nuk ka diskutime. Hapet votimi: 14 pro, 0 kunder, 0 abstenim.*

**Alfredi Gjata:** Vazhdojme me piken 9, Projekt-Vendim Nr.72 Datë 20.11.2025 "Për shtesën në buxhet sipas shkresës nr.14505/11 prot datë 24.10.2025 nga Ministria e Financave mbi zbatimin e aktit normative nr.10datë 08.10.2025."

Nuk ka diskutime.

*Hapet votimi: 14 pro, 0 kunder, 0 abstenim.*

**Bledi Diko:** Eshte nje shtese ne buxhet, nga Ministria e Financave ne mbeshtetje te shperblimet per sektorin e zjarrfikeseve. Propozuam qe kjo transferte te perdoret neper bankat e sektorit te zjarrfikeseve.

*Hapet votimi: 14 pro, 0 kunder, 0 abstenim.*

**Alfredi Gjata:** Vazhdojme me piken 10, Projekt-Vendim Nr. 73 Datë 20.11.2025 "Për miratimin e dokumentit të politikave, planit të aktiviteteve të Këshillit te Bashkisë Devoll, planin e konsultimeve dhe miratimin e buxhetit per periudhën janar-dhjetor 2026."

**Kostandina Braholli:** Ketu kemi planifikuar planin e aktiviteteve te keshillit, planin e konsultimeve qe bejme cdo vit dhe ne fund eshte buxheti. Ne fund te buxheti, jane parashikuar keto qe perdoren me shume, qe mos te linim leke kot per shpenzime te panevojshme. Ato jane te ndara per materiale, degjesa publike, parashikime karburanti dhe dieta  per trajnime te ndryshme.

**Vladimir Kello:** Propozoj qe te bejme nje vizite te keshilli bashkiak i Kosturit sepse jemi rrethi qe eshte me fqinj me komunitetin Europian.

*Hapet votimi: 14 pro, 0 kunder, 0 abstenim.*

**Alfredi Gjata:** Vazhdojme me piken 11, Projekt-Vendim Nr.74 Datë 20.11.2025 "Për kuotat financiare te ushqimit në mensa e konvikte dhe percaktimin e kritereve per perfitimin e bursave e te pagesave per nënësit e arsimit parauniversitar në institucionet arsimore publike."

**Eduard Duro:** Na kq ardhur nje kerkese nganje qytetar tjeter qe e solli ne moment te fundit, prpozoj ta shtojme sot dhe ndryshimi te behet tani ne moment, pasi nuk ka me afat. Duke qene se kemi dhe kuota te lira per bursat qe jane ne dispozicion eshte e mira ta ndihmojme.

*Hapet votimi: 14 pro, 0 kunder, 0 abstenim.*

**Alfredi Gjata:** Tek rubrika te tjera kemi raportin e performances, me te cilin kesilltaret jane njohur me email, nuk ka diskutime.

*GJithashtu kemi dhe nje kerkese nga z. Niko Xhacka.*

'Kesh. Valbona Spaho lexon kerkesen.

Keshilli nuk ka kopetence ne zgjidhje e ketij problemi.

Kemi dhe nje kerkese nga z. Petrit Demiraj i cili ka ardhur dhe vete fizikisht ketu sot. Ai po merret me kete nisme pa interes, pa shperblim thjesht me deshiren atdhetare, kulturore qe kemi per mbrojtjen e valles devollice.

Z. Petrit Demiraj lexon kerkesen e tij, ku shprehet shkurtimisht se do te shqyrtohet nga Min. e Kultures dosja dhe vallja gorarce do te shpallet vlere kombetare. Qellimi eshte per te manipuluar Min. e Kultures sikur kjo valle luhet ne zonen e Gores, kerkon nga Keshilli Bashkiak Devoll prononcim te argumentuar ne RTSH Korca mbi historine dhe realitetin ne kete ceshtje. Pres reagim zyrtar drejtuar ministrit te kultures, reagim zyrtar ne prefekture dhe keshillin e qarkut, takim me grupin folklorik, valletaret, instrumentistet dhe drejtuesit e tyre per ti mbeshtetur ata edhe moralisht perballe ketij presioni. Valletaret dhe instrumentistet duhet te jene te bindur se te gjitha versionet jane te Devollices dhe se kane nderin dhe detyrimin ta ruajne nga sulmet e shumta per ta tjetersuar apo per ta marre ne pronesi vallen e stergjysherve te tyre.

**Oliver Mulla:** Ti ke mbeshtetjen tone edhe kur te behet ky koncert ne mund te marrim pjese dhe nuk mendoj qe askush nuk do tju ndaloje te kerceni vallen devollice ashtu si eshte. Gjithesesi ne do te konsultohemi perseri per te marre masa dhe per te ndjekur kete procedure se bashku.

**Eduard Duro:** Kam nje kerkese nga shoqeria Albco shpk, ftese per bashkepunim ne fushen e prodhimit te energjise fotovoltaike. Kerkojne qe te fusin dhe bashkine aksionere neprodhimin e energjise elektrike. Une e kam marre si kerkese, ja kam dhene zyres juridike per te pare anen teknike te marreveshjes qe mund te krijojme. Arsyeja qe kerkon bashkine aksionere eshte komoditeti dhe bashkia mund te fitoje me teper. Une lexova kete propozim dhe nese eshte ne rregull nga te gjitha anet une do te kerkoj autorizimin tuaj per kete.

*Mbledhja deklarohet e mbyllur.*

Protokolluesi :

Kostandina Brahollli